




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGJENCIA PROTIV KORUPCIE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.	01-712/15
Dep.		Br. Prot.	
Dep.		Prot No.	
Nr. I faq.		Data	11-03-2015
Broj stranica	02	Datum	
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGJENCIA PROTIV KORUPCIE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 10.03.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02/705/15, për z. zyrtarin e lartë, z. Arban Abrashi, Minister i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, për shkak se nuk ka të dhëna të mjaftueshme që argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, ne ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e paraparë sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marrë të ardhur në adresë të AKK-së, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokollit AKK-03-02/705/15, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë, z. Arban Abrashi, Ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Në informatën e marrë është dyshuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si Ministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, njëkohësisht ka një biznes dhe është i angazhuar edhe në një tjetër veprimtari private.

Duke vepruar sipas kompetencave dhe mandatit që kemi, janë grumbulluar informatat zyrtare të ofruara nga ARBK-ja, është krahasuar formulari për deklarinimin e pasurisë, dhe janë ndërmarr veprimet e parapara sipas rregullores së punës së AKK-së.

Andaj duke u bazuar në gjendjen reale si dhe duke marrë për bazë informatën e siguruar nga ARBK-ja, konstatojmë se z. Arban Abrashi, ka të regjistruar në ARBK-ë biznesin me emër

“Laris Group”sh.p.k, dhe po ashtu te njëjtin e ka te deklaruar ne formularin për deklarimin e pasurisë, duhet theksuar se z. Abrashi ne biznesin “Laris Group”sh.p.k, nuk ushtron funksion menaxhues, pasi qe ne këtë biznes si person i autorizuar është një person tjetër, andaj mund te themi se te qënurit pronar i një biznesi, nuk paraqet mos pajtueshmëri në ushtrim të funksionit publik, dhe ne baze te gjitha këtyre qe u than me larte konstatojmë se nuk kemi elemente të gjendjes së konfliktit të interesit,dhe mos pajtueshmeris ne ushtrim te funksionit publik te parapar sipas nenit 15.1 te ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Pretëni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

